




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit, duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 09/2023 për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, bënë këtë:

07-CIU/01-0024760/26

04-05-26

NJOFTIM

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË KLASËN E PARË PËR VITIN SHKOLLOR 2026/27

Të nderuar prindër,

Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë për vitin shkollor 2026/27 bëhet prej 15 maj 2026 deri më 15 qershor 2026, në të gjitha shkollat fillore të komunës së Mitrovicës.

I. Regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë

1. Fëmija regjistrohet në klasën e parë pasi të ketë mbushur moshën minimale gjashtë (6) vjeç.
2. Regjistrimi i fëmijës në klasë të parë para moshës minimale gjashtë (6) vjeç bëhet vetëm atëherë kur ka një vlerësim dhe rekomandim të një ekipi profesional, të caktuar nga shkolla. Ekipi vlerëson pjekurinë njohëse, sociale, motorike dhe emocionale të fëmijës duke përcaktuar gatishmërinë e fëmijës për të hyrë në klasë të parë. Vendimin përfundimtar e merr drejtori i shkollës.
3. Ekipi profesional përbëhet nga psikologu, pedagogu, mësuesi mbështetës i shkollës, etj.
4. Fëmija me diagnozë mjekësore para regjistrimit referohet tek ekipi komunal për vlerësim pedagogjik në Drejtorinë Komunale për Arsim, në komunën përkatëse.

II. Dokumentacioni

1. Për regjistrim në klasë të parë, fëmija duhet të ketë certifikatën e lindjes/ekstraktin e lindjes, certifikatën e vaksinimit dhe dëshminë për vendbanim nga bashkësia lokale, e cila nuk është më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
2. Dokumentet e prindit/kujdestarit ligjor.
3. Formulari i regjistrimit plotësohet në momentin e regjistrimit pranë institucionit arsimor.
4. Për fëmijët që kanë ndjekur edukimin parafillor, në raste specifike mund të kërkohet edhe një vlerësim përshkrues për fëmijën nga edukatorja.

III. Zonimi

Për regjistrim të fëmijës në klasën e parë, drejtorja e shkollës bazohet në sistemin e zonimit të përcaktuar nga komuna përkatëse.

Për detajet e tjera do të informoheni nga shkollat që janë brenda zonës tuaj.

Të gjithë fëmijëve u urojmë suksese!



Me respekt,

Shefki Begu, Drejtor i Arsimit